

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Financave dhe Ekonomise
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS KAPSHTICË

Nr. 103 Prot
7

Kapshtice, datë 14/06/2022



LËNDA: Kërkesë për shpallje publike

DREJTUAR: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT / TIRANE

DREJTUAR: DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE

Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1,
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për;

Subjekti/shtetasin: Arben Grabovari me ID G10605022L

Vendimi: Nr 103 date 01/06/2022

Detyrimi: 1.424.235 leke detyrime doganore dhe 8.545.410 leke penalitete.

Me adresë: Rr. "Thanas Ziko", Nr 40 Njesia administrative Nr 8, Tiranë.


Lutemi qe për vazhdimin e procedurave ligjore për rikuperimin e borxhit doganor është domosdoshmëri data e shpalljes publike(bashkwlidhur vendimi Nr 103 date 01/06/2022)

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

KRYETARI I DEGES SE DOGANES KAPSHTICE

HERKUL MARKO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS KAPSHTICË

VENDIM
Nr. 13 date 01.06.2021

Autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Kapshtice, perfaqesuar nga Kryetari i Degës Doganore Kapshtice dhe njëkohesisht vendimmarrësi, mori në shqyrtim shkresën nr.4492 prot., datë 03/03/2022 të dërguar nga Drejtoria e Hetimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me lënde "Informacion për marrje vendimi", njëkohesisht proces verbalin për verifikimin e kontrabandës të mbajtur nga Drejtoria e Hetimit me numër serial 0006311 date 28/02/2022, shkresat për njoftim akte keto te mbajtura lidhur me shkeljet doganore të konstatuar gjatë hetimeve të kryera për shtetasin z.Arben Toku Grabovari, i datëlindjes 05/06/1961, me numër personal i identifikimi G10605022L, me adresë Rruga "Thanas Ziko", Nr.40, Njësia Administrative nr.8, Tiranë dhe

KONSTATOHET SE:

Nga shkresa Informacion për Marrje Vendimi, njëkohesisht proces verbali për verifikimin e kontrabandës të mbajtur nga Drejtoria e Hetimit me numër serial 0006311 date 28/02/2022, shkresat për njoftim, akte keto te mbajtura lidhur me shkeljet doganore të konstatuar gjatë hetimeve të kryera për shtetasin z.Arben Toku Grabovari, i datëlindjes 05/06/1961, me numër personal i identifikimi G10605022L, me adresë: Rruga "Thanas Ziko", Nr.40, Njësia Administrative nr.8, Tiranë, rezultoi i evidentuar fakti se, në vijim të punës së përditshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, dhe bazuar në protokollin e 6 në lidhje me asistencën e ndërsjellë në fushën doganore të Marrveshjes së Stabilizim Asocimit midis Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë nr 9560 date 27/7/2006, nga ana e autoriteteve doganore Franceze, janë kërkuar të dhëna për shtetasin shqiptar, me emrin Arben Grabovari me nr. ID G10605022L, lindur në Tiranë më 05.06.1961, por gjithashtu me kombesi dhe pasaporte greke nr AN443581 me emrin Armpen Gkrampovaris.

Rezultoi gjithashtu, se nga ana e Drejtorisë së Hetimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave kanë vijuar verifikimet në bashkëpunim, me të gjithë agjensitë ligjzbatuese në vend dhe në vazhden e këtyre verifikimeve paraprake, duke kqyrrur sistemin TIMS rezultoi se nga kërkimi në këtë sistem nga data 01.01.2015 deri 21.04.2019 duke filluar nga data 21.03.2017 ky shtetas duke përdorur pasaportën greke, ka hyrë nga Pikat e Kalimit Kufitar toksore 64 herë, me mjete të ndryshme. Gjithashtu duke ju referuar sistemit TIMS në 60 raste, mjetet me të cilat ka hyrë duke përfutur Regjimin e Lejimit të Përkohshëm (RLP) në shkelje të legjislacionit, nuk kanë dalë nga territori doganor shqiptar dhe as nuk janë deklaruar për zhdoganim pranë degëve doganore në Republikën e Shqipërisë, pra këto mjete janë hedhur në qarkullim të lirë, pa paguar detyrimet doganore, perkatesisht si me poshte:

- 1-Mjeti me targa CJ03AUW, i llojit Mercedes, vit prodhimi 2003, me fuqi 2685, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 30.07.2018, në Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 88815 leke.
- 2-Mjeti me targa VE07PWZ, i llojit Volkswagen, vit prodhimi 2007, me fuqi 1968, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 27.08.2018, në Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 73803 leke.
- 3-Mjeti me targa AM08WNZ, i llojit Volkswagen, vit prodhimi 2008, me fuqi 2000, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 03.09.2018, në Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 73840 leke.
- 4-Mjeti me targa WG54AAE, i llojit Mercedes, vit prodhimi 2004, me fuqi 1796, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 29.06.2018, në Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 48814 leke.
- 5-Mjeti me targa BT54OYP, i llojit Mercedes, vit prodhimi 2004, me fuqi 1796, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 08.07.2018, në Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 48815 leke.
- 6-Mjeti me targa ERJ06XHA, i llojit panjohur vit prodhimi panjohur, me fuqi panjohur, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 22.07.2018, në Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 0 leke.



8- Mjeti me targa EK09ZHG, i llojit Mercedes, vit prodhimi 2009, me fuqi 2987, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 21.03.2017, ne Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 264487 leke.

9- Mjeti me targa DN03ZPW, i llojit Mercedes, vit prodhimi 2003, me fuqi 2148, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 03.04.2017, ne Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 69529 leke.

10- Mjeti me targa VK58WFZ, i llojit Volkswagen, vit prodhimi 2008, me fuqi 2685, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 19.04.2017, ne Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 59529 leke.

11- Mjeti me targa RV05NVH, i llojit Mercedes, vit prodhimi 2005, me fuqi 1796, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 02.05.2017, ne Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 39529 leke.

12- Mjeti me targa WV56DXC, i llojit Land Rover, vit prodhimi 2006, me fuqi 2720, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 28.05.2017, ne Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 69309 leke.

13- Mjeti me targa HS55FLV, i llojit Jaguar, vit prodhimi 2006, me fuqi 2720, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 19.10.2017, ne Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 69359 leke.

14- Mjeti me targa VN55CLU, i llojit Audi, vit prodhimi 2005, me fuqi 1986, lloji i karburantit diesel, me date hyrje 09.05.2017, ne Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 59452 leke.

15- Mjeti me targa J90NNW, i llojit Mercedes, vit prodhimi 2008, me fuqi 2987, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 23.03.2018, ne Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 89256 leke.

16- Mjeti me targa SD04XLS, i llojit Volkswagen, vit prodhimi 2004, me fuqi 1900, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 05.06.2018, ne Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 73814 leke.

17- Mjeti me targa NG06CVA, i llojit Volkswagen, vit prodhimi 2006, me fuqi 2000, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 20.06.2018, ne Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 73814 leke.

18- Mjeti me targa ERJ06XHA, i llojit panjohur, vit prodhimi panjohur, me fuqi panjohur, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 22.07.2018, ne Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 0 lek.

19- Mjeti me targa SB09EAC, i llojit Volkswagen, vit prodhimi 2009, me fuqi 1984, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 06.08.2018, ne Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 73815 leke.

20- Mjeti me targa YR09KTP i llojit Mercedes, vit prodhimi 2009, me fuqi 2987, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 16.08.2018, ne Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 88803 leke.

21- Mjeti me targa VN55CLU, i llojit Audi, vit prodhimi 2005, me fuqi 1986, lloji i karburantit Diesel, me date hyrje 09.05.2017, ne Piken Doganore Kapshtice, detyrimi doganor 59452 leke.

si edhe evidentohet ne akte se mjeti me targe CV57XGH ka dale me date 05.01.2018 nga PKK Qafe Thane.

Duke ju referuar legjislacionit ne fuqi, në nenin 650 të Vendimit te Keshillit te Ministrave nr 651 date 10.11.2017, pasqyrohet se aplikimi për RLP duhet të paraqitet pranë Policisë Kufitare dhe Migracionit, të cilës i delegohet e drejta për vendosjen nën Rregjimin e Lejimit të Përkohshëm të

automjeteve rrugore për përdorim privat, të cilat plotësojnë kushtet për dhënien e këtij regjimi dhe se vendosja nën këtë regjim, si rast specifik, bëhet nëpërmjet regjistrimit në rrugë elektronikë, në

sistemin TIMS.

Gjithashtu parashikohet se mbikëqyrja dhe mbyllja e këtij regjimi bëhen nga autoritetet doganore, në bashkëpunim me Policinë Kufitare dhe Migracionit, sipas kompetencave, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Njekohesisht referuar Udhëzimit nr. 4 datë 04.02.2010 të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshëm "Për zbatimin e procedurave të miratimit, mbikëqyrjes dhe përmbylljes së Regjimit të

Lejimit të Përkohshëm të automjeteve të huaja për përdorim privat", në kreun 4 dhe në pikën 3 parashikohet se për automjetet e huaja për përdorim privat me drejtues që regjistrohen në Sistemin

TIMS, nuk përfitojnë Regjimin e Lejimit të Përkohshëm (RLP) në rastet kur, konstatohet një person i cili importon, brenda një periudhe 6-muaj, më shumë se një mjet dhe për të cilët nuk është mbyllur

Regjimi i Lejimit të Përkohshëm (RLP). Ndaj këtyre personave do të mbahet proces-verbali i konstatimit dhe do të njoftohen menjëherë përgjegjësat e turnit. Ky mjet do të kalojë në parkimin

doganor për veprime të mëtejshme doganore dhe regjistrimi i tij do të bëhet në Sistemin Elektronik Lokal" dhe parashikohet se me tej autoritetet doganore vijojnë procedurat standarte.

Pra rezultoi se nga shtetasi, shqiptar, z. Arben Grabovari me nr. ID G10605022L, lindur në Tiranë

gjithashtu me kombesi dhe pasaporte greke nr AN443581 me emrin Armpen

Gkrampovaris, nuk janë deklaruar për zhdoganim këto automjete të cilat kanë hyrë nga Pika e Kalimit Kufitar Kapshticë, pra nuk është mbyllur Regjimi i Lejimit të Përkohshëm (RLP), me qëllim shmangien e detyrimeve doganore që duheshin paguar në shumën 1.424.235 lekë, shkelje kjo e parashikuar në nenet 250/1/2, 266/1 dhe 268 të Ligjit 102/2014, i ndryshuar.

Shtetasi shqiptar, z. Arben Grabovari me nr. ID G10605022L, lindur në Tiranë më 05.06.1961, por gjithashtu me kombesi dhe pasaporte greke nr AN443581 me emrin Armpen Gkrampovaris, duhet të paguajë shumën e detyrimit doganor të shmangur në vlerën 1.424.235 lekë dhe në bazë të neneve 250/1/4, 268/2 dhe 269 të Kodit Doganor, duhet të penalizohet me gjobë 8.545.410 lekë, sa 6 fishi i detyrimit doganor të shmangur.

Me shkresën nr.484/1 prot, datë 18.03.2022 Dega e Doganës Kapshticë ka kërkuar informacion më të saktë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, në lidhje me të dhënat personale dhe adresën e vendbanimit për shtetasin z.Arben Grabovari.

Referuar të dhënave të dërguara nga Zyra e Drejtorise se Pergjithshme te Gjendjes Civile me shkresën nr.3101/1 prot, datë 04.04.2022, protokolluar pranë Degës së Doganës Kapshticë me nr.484/3 prot, datë 08.04.2022, për shtetasin e sipërcituar, rezulton të jetë në adresë e dhënë në kete shkrese.

Për vazhdimin e procedurave sa më të rregullta ligjore, Dega Doganore Kapshtice, me shkresën nr.484/4 prot, datë 12.04.2022, ka derguar njoftim mbi proces verbalin per shtetasin z. Arben Grabovari me nr. ID G10605022L, lindur në Tiranë më 05.06.1961, në adresën e dhënë e cila është kthyer referuar akteve të administruara.

Dega Doganore Kapshtice, ka riderguar serisht shkresën nr.484/4 prot, datë 12.04.2022, me titull dergim informacioni dhe dokumentacion, pra njoftim mbi proces verbalin per shtetasin z. Arben Grabovari me nr. ID G10605022L, lindur në Tiranë më 05.06.1961, në adresën e dhënë e cila është rikthyer sipas akteve të administruara.

Për vazhdimin e procedurave sa më të rregullta ligjore, Dega Doganore Kapshtice, me shkresën në kuadër të bashkëpunimit ndërinstucional, referuar nenit 162 të ligjit nr.44/2015 datë 30.04.2015 "Kodit të Procedures Administrative të Republikës së Shqipërisë" ka bërë kërkesë për shpallje publike të proces verbalit të mbajtur nga Drejtoria e Hetimit, me shkresën Nr 484/6 date 26.04.2022 drejtuar Bashkia Tiranë, Njësia Administrative nr.8.

Me shkresën nr. 1330/1 prot., datë 06.05.2022, protokolluar pranë Degës së Doganës Kapshticë me nr. 484/7 prot., datë 09.05.2022, Bashkia Tiranë, Njësia Administrative nr.8, na konfirmon se shpallja për z. Arben Grabovari është afishuar në këndin e njoftimeve me datën 05.05.2021 dhe njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 162, të ligjit të sipërcituar, date nga e cila fillon afati 10 ditor per paraqitje te pretendimeve referuar dispozitave ligjore, por rezulton dhe si rrjedhim, shtetasi nuk ka paraqitur ankim mbrenda këtyre afateve.

Rezulton gjithashtu se mbeshtetur tek referimi me shkrim Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka rregjistruar procedimin penal nr. 1654/2019, kreu hetimet dhe e dërgoi për çështjen për gjykim, organ i cili ka kërkuar edhe vlerësimin e detyrimit doganor të shmangur dhe me shkresë nr 16106/1 prot date 25.06.2019 ka dërguar tabelën me llogaritjet përkatëse të detyrimit doganor që duhej të paguaj secili automjetet, te pershkruara me siper.

Nga sa më sipër, në përmbledhje të fakteve të dhëna dhe informacionit që disponojmë, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Kapshtice, gjen të drejtë zbatimin e nenit 650 e vijues të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 651 datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar; ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, nenit 72 e vijues; nenit 273 pika 2, të nenit 250 pika 4; të nenit 250 pika 3; te nenit 250 pika 7; të nenit 267, nenit 268 pika 2, dhe 269 pika 1, të Ligjit Nr. 102/2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ndaj

VENDOSA:

Shtetasi z. Arben Grabovari me nr. ID G10605022L, lindur në Tiranë më 05.06.1961, por gjithashtu me kombesi dhe pasaporte greke nr AN443581 me emrin Armpen Gkrampovaris, me adresë Rruga "Thanas Ziko", Nr.40, Njësia Administrative nr.8, Tiranë te shpallet debitor per detyrimin doganor te papaguar/shmangur te mjeteve te pershkuara ne pjesen arsyetuese, referuar nenit 250/4/7 te ligjit 102/2014, ne masen 1.424.235(nje milion e katerqind e njezet e kater mije e dyqind e tridhete e pese) lek.

2. Shtetasi z. Arben Grabovari me nr. ID G10605022L, lindur në Tiranë më 05.06.1961, por gjithashtu me kombesi dhe pasaporte greke nr AN443581 me emrin Armpen Gkrampovaris, me adresë Rruga "Thanas Ziko", Nr.40, Njësia Administrative nr.8, Tiranë te penalizohet me gjobë qe perkon me 6-fish-in e detyrimit doganor te mesiperm, neni 269/1, ne vlere 8.545.410(tete milion e peseqind e dyzet e pese mije e katerqind e dhjete) lek.
3. Kunder këtij vendimi mund të beni ankim kundrejt një kerkese të arsyetuar pranë Drejtorit të Pergjithshem te doganave, brenda 30 diteve nga data e njoftimit të vendimit, në mbeshtetje të nenit 281 e vijues të Kodit Doganor, duke plotesuar kushtin per pagese te detyrimeve doganore te aplikuar dhe njekohesisht garantim te penalitetit te aplikuar ne kete vendim,
4. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Zyrës së Financës për kontabilizimin e borxhit doganor dhe një e kopje e këtij vendimi i dërgohet Drejtorisë së Hetimit.

KRYETARI I DEGES SE DOGANES KAPSHTICE
HERKUL MARKO

